



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

**RREGULLORE PËR PROCEDURËN E
ZGJEDHJES PËR THIRRJET SHKENCORE
E KOLEGJIT BIZNESI**

Prishtinë 2020

Rregullore “për procedurën e zgjedhjes për thirrjet shkencore e Kolegjit BIZNESI” është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, Statutin e Kolegjit neni 81, në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor nr. ____ datë __.__.2020, si dhe me Vendim të Bordit nr. ____ datë __.__.2020, të Kolegjit BIZNESI.

Neni 1 Baza Ligjore

1. Rregullorja për procedurën e zgjedhjes për thirrjet shkencore e Kolegjit BIZNESI, bazohet në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, ligjin Nr. 03/L-060, “Për Kualifikimet Kombëtare”, Statutin e Kolegjit neni 81 dhe në legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Rregullorja është objekt i ndryshimeve në formë dhe në përmbajtje, konform çdo ndryshimi të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Statutit të Kolegjit BIZNESI, si dhe respekton çdo akt ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Kosovës për sistemin dhe parimet e funksionimit të Arsimit të Lartë.

Neni 2 Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktohen kriteret unike dhe procedurat për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrje bashkëpunëtori në Kolegj.

Neni 3 Nevojat për zgjedhje në thirrjet akademike

1. Është e nevojshme të zhvillohen procedurat për zgjedhjen për thirrjet shkencore të personelit akademik të Kolegjit “BIZNESI” sepse:

a) Aktiviteti mësimor dhe kërkimor-shkencor në departamente bëhet nga persona të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrje bashkëpunëtori në Kolegj;

b) Aktivitet të arsimit sipëror mund të bëjë personi i zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, përkatësisht thirrje mësimore, për kohën për të cilën është zgjedhur.

Neni 4 Krijimi i kushteve për aftësimin e specialistëve

1. Më qëllim të përgatitjes së specialistëve për veprimtari kërkimore shkencore dhe profesionale, e duke u bazuar në legjislacionin përkatës dhe statutin e rregulloren e brendshme të Kolegjit “BIZNESI” dhe për të mbështetur zhvillimin e programeve mësimore të fushave të akredituara, Kolegji krijon kushte për arritjen e thirrjeve akademike për personelin akademik të angazhuar me veprimtari mësimore shkencore pranë këtij institucioni.

Neni 5 Personeli akademik dhe titujt shkencor

1. Personeli akademik i Kolegjit “BIZNESI” përbëhet nga:

a) Specialistët për:

- Mësimdhënie akademike;

- Kërkime shkencore;

- Krijimtari të lëndëve mësimore.
2. Titujt shkencor janë:
- Profesorët e rregullt,
 - Profesorët e asociuar,
 - Profesorët asistent,
 - Ligjërues,
 - Asistentët,
 - Asistent i ri,
 - Bashkëpunëtor profesional.

Neni 6

Standardet për të fituar titullin akademik “Profesor i Asistent”

1. Titulli akademik “profesor i asistent” jepet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit, për lektorët të cilat plotësojnë kriteret ligjore.
2. Kërkesat të cilat vlerësohen të nevojshëm të jenë plotësuar për fillimin e procedurave për zgjedhjen në titullin profesor asistent (docent), përveç kërkesave të parapara me ligj dhe mbi bazë të së cilës vërtetohen notat e përgjithshme të raportit të komisionit recensues, janë edhe:
 - të ketë fituar gradën shkencore doktor i shkencave të fushës përkatëse shkencore nga e cila zgjidhet;
 - të ketë së paku 3 (tre) punime shkencore të publikuara në revista shkencore;
 - të ketë aftësi të treguara për punë kualitative në procesin edukativo–arsimor;
 - të ketë punuar dispensë interne të ushtrimeve ose praktikës, e lejuar nga Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor, ose së paku 3 punime profesionale (shkencore të mirënjohura);
 - pjesëmarrje në projekte shkencore;
 - pjesëmarrje në punë të shoqatave profesionale ose forma tjera të punës edukativo-shkencore në Kolegjin “BIZNESI”.
3. Në punimet shkencore, kandidati duhet të jetë autor udhëheqës (kryesues), ndërsa ato duhet të jenë të botuara ose të paraqitura në mënyrë të tillë që profesioni (drejtimi) t’iu pranojë njohuri ndërkombëtare dhe të kenë njohuri të kulturës nacionale ose shtetërore.

Neni 7

Standardet për të fituar titullin akademik “Profesor i Asociuar”

1. Titulli akademik “profesor i asociuar” jepet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit, për lektorët të cilat plotësojnë kriteret ligjore.
2. Aplikimet për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” kryhen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Lektor”.
3. Personeli akademik i kategorisë “lektor” aplikon për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore “doktor”.
4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin “profesor i asociuar”, duhet:
 - a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;
 - b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 3 (tre) vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një

periudhë 5 (pesë) vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”;

c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme.

5. Personeli akademik, që aplikon për titullin “profesor i asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

a) Ka botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 3 (tre) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njëra bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

7. Për efekt të promovimit akademik, institucioni merr në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, në:

a) grupe pune shkencore apo redaktuese;

b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;

c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;

- ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - e) si drejtues në komitetet (këshillat) organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.
8. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:
- a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;
 - b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
9. Për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore “doktor”, deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “profesor i asociuar”.

Neni 8

Standardet për të fituar titullin akademik “Profesor”

1. Titulli akademik “profesor” jepet nga institucioni, për ata kandidatë të cilat plotësojnë kriteret ligjore.
2. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “profesor i asociuar”, aplikon për fitimin e titullit akademik “profesor”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”.
3. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “profesor”, duhet:
 - a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
 - b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 5 (pesë) vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, ose me kohë të pjesshme, si lektor, për një periudhë 8 (tetë) vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore “doktor”;
 - c) të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar;
 - ç) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në një nga këto gjuhë.
4. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

a) Ka botuar, së paku, 4 (katër) artikuj shkencorë, në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 3 (tre) referime, nga të cilat 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

5. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njëra bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës;

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

6. Për efekt të promovimit akademik, institucioni merr në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”, në:

a) grupe pune shkencore apo redaktuese;

b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose jo-periodikëve shkencorë;

c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;

ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;

dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;

e) si drejtues në komitetet (këshillat) organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;

ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

7. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, mund të ekuivalenohet me:

a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;

b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

8. Për fitimin e titullit akademik “profesor”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik “profesor i asociuar” deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “profesor”.

Neni 9

Tituj për vlerësim dhe nderim

1. Kolegji ”BIZNESI” mund të akordojë titullin “*Doktor Honoris Causa*” për figura të shquara të shkencës e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit e të shkencës, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërësi. Ky titull jepet me vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Numri i titujve “*Doktor Honoris Causa*” që një IAL mund të akordojë, si rregull, nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

2. Kolegji, në rregulloren e brendshme, ka të përcaktuar procedurën dhe kriteret për fitimin e titullit “*Profesor Emeritus*” nga anëtarët e personelit akademik që mbajnë titullin “profesor”, pas daljes së tyre në pension, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Kandidati për titullin “*Profesor Emeritus*” dallohet nga arritjet e veçanta akademike dhe shkencore gjatë periudhës së aktivitetit të tij. Kualifikimet e tij konsiderohen të pa zëvendësueshme për një periudhë afatmesme. Kjo nevojë duhet të detajohet nga komisioni i vlerësimit.

4. “*Profesori Emeritus*” do të ketë të drejtën të jap mësim dhe të merret me punë shkencore në pajtim me kualifikimet e tij dhe kërkesave të Kolegjit.

5. Çështjet e tjera rreth të drejtave dhe përgjegjësisë të “*Profesorit Emeritus*” caktohen me kontratë individuale të lidhur nga Kolegji i përfaqësuar nga Dekani me miratim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit.

Neni 10

Kriteret për zgjedhjen në thirrje profesionale - shkencore

1. Si lektor mund të zgjidhet personi, i cili ka kryer studime pasdiplomike dhe ka fituar gradën ”doktor” në lëmin shkencor në të cilin zgjidhet, si dhe tregon aftësi për punë mësimore, aftësi të lartë profesionale, zotëron kërkesat e disiplinës së fituar dhe ka përvojë në mësimdhënie e në marrëdhëniet me studentët.

Neni 11

Kriteret për zgjedhje në titull: Asistent i ri, Asistenti, Ligjërues dhe Bashkëpunëtor profesional

1. Asistent i ri mund të zgjidhet personi i cili ka të kryer arsimim të lartë përkatës me notë mesatare së paku 8.00 dhe ka regjistruar studimet e postdiplomës në drejtimin përkatës, ka moshën nën 25 vjeçare, zotëron një nga gjuhët botërore dhe tregon aftësi për punë mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe tregon interes të posaçëm për lëmin, përkatësisht lëndën për të cilën zgjidhet.

2. Asistent mund të zgjidhet personi i cili ka të kryer studime pasdiplomike, magjistraturë në lëmin shkencor përkatës, zotëron një nga gjuhët botërore dhe tregon aftësi për aktivitetet mësimor shkencor.

3. Ligjërues mund të zgjidhet personi i cili ka kryer studime pasdiplomike dhe ka magjistruar në lëmin shkencor në të cilin zgjidhet dhe tregon aftësi për punë mësimore, aftësi të lartë profesionale, zotëron problemet e disiplinës së vet dhe ka përvojë të veçantë në mësimin teorik dhe praktik. Ai duhet të ketë së paku tri punime kërkimore shkencore dhe të ketë kaluar titullin asistent në së paku një mandat zgjedhjeje me këtë titull. Zgjedhja në thirrje mësimore-shkencore bëhet në mënyrë periodike.

4. Bashkëpunëtor profesional mund të zgjidhet personi i cili ka kryer studime universitare në lëmin shkencor në të cilin zgjidhet dhe tregon aftësi për punë mësimore, aftësi të lartë profesionale, ose i cili ka kryer arsimim të lartë përkatës, zotëron problemet e disiplinës së vet dhe ka përvojë të veçantë në mësimin profesional praktik.

Neni 12

Afatet për të cilët bëhet zgjedhja

1. Profesor Asistent (docenti), Profesori i Asocuar (profesori inordinar) dhe Profesori (profesori ordinar) zgjidhen në afat prej 3-5 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Asistenti i ri zgjidhet në afat prej 3 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Asistenti zgjidhet në afat prej 3 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një afat.

4. Ligjëruesi zgjidhet në afat prej 3 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

5. Bashkëpunëtori profesional zgjidhet në afat prej 3 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 13

Përgatitjet për zgjedhje

1. Kolegji "BIZNESI" bën shpalljen publike të konkurrimit për zgjedhje në titujt shkencor sipas kompetencës që i ka dhënë ligji.

2. Vendim për hapjen e procedurës për zgjedhje në thirrje, në rast se zgjedhja bëhet për herë të parë, sjell Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit.

3. Vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhje të personave të zgjedhur sjell Dekani gjashtë muaj para kalimit të kohës në të cilën janë zgjedhur.

4. Konkursin për zgjedhje e shpall dekani.

5. Zgjedhja në thirrje mësimore-shkencore, thirrje mësimore dhe bashkëpunëtorë bëhet nëpërmjet konkursit publik të shpallur në mjetet e informimit dhe në veb-faqen e Kolegjit.

6. Konkursi zgjat 15 ditë nga dita e shpalljes.

7. Konkursi duhet të përmbajë lëmin që i takon veprimtarisë përkatëse mësimore shkencore, për të cilin zgjidhet kandidati, afatin, si dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje.

8. Procedura për konkursin për zgjedhje mësimore shkencore, mësimore, mësimore profesionale dhe thirrje bashkëpunëtori në fakultete zgjat 3 muaj. Një ditë pas përfundimit të konkursit fillon procedura e lartpërmendur.

Neni 14

Procedurat për fitimin e titujve akademikë

1. Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit (Dekanit) të Kolegjit, i cili bën vlerësimin e pranueshmërisë ligjore të dosjes së kandidatit përkatës brenda 20 (njëzet) ditëve. Pas vlerësimit nga udhëheqja dhe gjetjes në përputhje me ligjet në fuqi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, dosja e kandidatit i përcillet Komisionit të Karrierës (Komisioni për promovimin e personelit akademik), i cili, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit.

2. Nëse drejtuesi (Dekani) i Kolegjit jep vlerësim negativ, dosja i kthehet kandidatit me argumentet dhe sugjerimet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh.

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Komisionit të Karrierës, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati është e plotë apo jo. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Këshilli vijon menjëherë me ngritjen e komisionit për vlerësimin e dosjes. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.

4. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së Komisionit të vlerësimit të dosjes.

5. Komisioni vlerësues i dosjes përbëhet nga 3 (tre) anëtarë me titullin akademik “profesor” të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit. Anëtarët e jurisë propozohen nga Dekani dhe miratohen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit.

6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, Komisioni përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit.

7. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga Komisioni.

8. Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit, kandidati i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme, pranë drejtuesit të Kolegjit.

9. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në regjistrat përkatës të IAL-së. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga Dekani.

Neni 15

Zgjedhja e parakohshme në thirrje më të lartë

1. Kandidati në thirrje mësimore-shkencore, thirrje mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori mund të zgjidhet në thirrje më të lartë në lëmin e njëjtë mësimor-shkencor edhe para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur, nëse i plotëson kushtet për zgjedhje të parapara me këtë rregullore: nëse ka kaluar së paku gjysmën e kohës në thirrjen që ka, tregon sukses të veçantë në procesin mësimor, punën shkencore në lëmin gjegjës, respektivisht në punën profesionale akademike dhe nëse ka kontribuar veçanërisht në aplikimin dhe zbatimin e veprimtarisë shkencore në lëmin për të cilën është zgjedhur.

2. Iniciativë për avancim të parakohshëm të kandidatit marrin së paku dy programe ose njësi organizative të Kolegjit nga veprimtaria e njëjtë mësimore shkencore për ku bëhet zgjedhja, me propozim të arsyetuar me shkrim, ku veçanërisht potencohen rezultatet e mira të kandidatit.

3. Nëse në kuadër të Kolegjit nuk ka njësi organizative nga ajo veprimtari mësimore shkencore, iniciativën për avancim të parakohshëm mund ta marrë njësi organizative nga organizata tjetër e arsimit të lartë në kuadër të Kolegjit "BIZNESI".

4. Pas iniciativës së arsyetuar për nisjen e procedurës për avancim të parakohshëm, vendimin përfundimtar për nisjen ose jo të procedurave e merr Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit.

5. Zgjedhjen e kandidatit në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrje në bashkëpunëtor e bën Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit, në bazë të vlerësimit të referatit të komisionit për recension.

Neni 16 **Komisioni recensues**

1. Komisionin recensues e formon Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit "BIZNESI" në afat jo më vonë se 5 - 10 ditë nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e kërkesës së kandidatit.

2. Dekani në afat prej jo më vonë se 8 ditëve i lajmëron anëtarët e Komisionit recensues për formimin dhe përbërjen e komisionit recensues.

3. Komisioni recensues përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë nga fakultetet ku bëhet zgjedhja dhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit.

4. Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë në thirrje më të ulët se thirrja për të cilën konkurron dhe zgjidhet kandidati.

5. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë edhe persona të pensionuar me thirrje mësimore shkencore, thirrje në profesor të rregullt të cilët i plotësojnë kushtet nga kjo Rregullore. Më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit recensues e përbëjnë personat në thirrje mësimore shkencore dhe mësimdhënës të po të njëjtës lëmi, ndërsa anëtarët tjerë mund të jenë të drejtimeve të përafërta mësimore shkencore.

6. Afërsinë e përcakton Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit, në bazë të veprimtarisë shkencore dhe disiplinave të përcaktuara nga Kolegji.

7. Komisioni recensues ofron raport për të gjithë kandidatët e paraqitur dhe propozon njërin nga kandidatët që i plotëson kushtet për zgjedhje në thirrje dhe i propozon thirrjet në të cilën mund të zgjidhet. Komisioni recensues është i obliguar të dorëzojë raport në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimeve për zgjedhjen e anëtarëve të vet dhe të dokumentacionit.

8. Nëse komisioni recensues nuk dorëzon raport në afatin e caktuar, formohet komision i ri recensues. Propozimin e ri për formimin e komisionit recensues e ofron Dekani.

9. Komisioni recensues propozimin për zgjedhje të kandidatit e miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

10. Nëse komisioni recensues nuk ka propozim, formohet komisioni i ri recensues.

11. Raporti i komisionit recensues përmban: të dhëna biografike të kandidatit, vlerësimin e të arriturave shkencore, profesionale, pedagogjike dhe të arritura tjera të kandidatit të cilat janë me rëndësi për përcaktimin e kushteve për zgjedhje në thirrje, të dhëna për shpalljen e punimeve shkencore dhe profesionale nga vlerësimet e atyre punimeve si dhe propozim për zgjedhjen e kandidatit në thirrje të caktuar.

12. Raporti shpallet në gjuhën shqipe.

13. Nëse ekzistojnë mendime të ndara të anëtarëve të komisionit recensues nga propozimi për zgjedhje të kandidatit, mendimet së bashku me raportet shpallen në buletin e Kolegjit.

14. Nëse në konkurs paraqiten kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje adekuate, komisioni recensues konstaton mosplotësimin e kushteve dhe për këtë e njofton Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit.

15. Në afat prej 5 ditësh nga dita e publikimit të raportit nga Komisioni recensues në buletin e Kolegjit, personat e interesuar (pjesëmarrës në procedurë, punëtorë mësimor-shkencor, mësimdhënës dhe bashkëpunëtor nga programe dhe nga lëmit përkatëse mësimore shkencore të institucioneve të arsimit të lartë) mund të dorëzojnë kundërshtim ndaj raporteve përkatëse të shpallura për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori.

16. Kundërshtimi i dorëzohet komisionit recensues nëpërmjet Dekanit. Komisioni recensues jep përgjigje ndaj kundërshtimit në afat prej 5 ditësh.

Neni 17

Vendosja për zgjedhje

1. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit “BIZNESI” procedon dhe voton zgjedhjen e kandidatëve për thirrje mësimore-shkencore nëse janë prezentë dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit me të drejtë vote.

2. Punonjësi mësimor shkencor i Kolegjit zgjidhet nëse fiton shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit të Kolegjit me të drejtë vote.

3. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit bën zgjedhjen në thirrje të bashkëpunëtorit, nëse në mbledhje janë prezent dy të tretat nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor me të drejtë vote.

4. Nëse gjatë zgjedhjes punonjësi mësimor-shkencor dhe bashkëpunëtori për thirrje më të lartë nuk e fiton shumicën e duhur të votave, atëherë i njëjti mbetet në thirrjen që ka.

Neni 18

Personat që nuk janë zgjedhur

1. Kandidati që nuk zgjidhet, ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e njoftimit për mos-zgjedhje. Ankesa i drejtohet Komisionit të formuar nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit.

2. Komisioni i formuar nga Këshilli, në afat prej 30 ditëve nga pranimi i ankesës së kandidatit, formon komision tre anëtarësh me tituj profesorë ordinar, nga të cilët, dy do të jenë nga fusha e njëjtë ose e përafërt mësimor shkencor me fushën e ankuesit.

3. Komisioni në afat prej 30 ditësh, dorëzon raport në Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit me vlerësim për zgjedhjen ose mos-zgjedhjen me arsyetimin përkatës.

4. Komisioni mund të propozojë që kandidati të zgjidhet në thirrje ku më parë ka qenë i zgjedhur, të propozojë të zgjidhet në thirrje për të cilën ka konkurruar kandidati ose të propozojë që të përkrahet vendimi i Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit.

5. Vendimi i Komisionit është përfundimtar.

Neni 19

Ndërprerja e parakohshme e zgjedhjes

1. Kandidatit të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës edhe para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur, në kushte dhe procedurë të përcaktuar me Statutin e Kolegjit "BIZNESI".

2. Iniciativë për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes merr Dekani i Kolegjit "BIZNESI", organi i njësisë së brendshme organizative, ose së paku 5 punonjës shkencor-mësimor. Këtë iniciativë e shqyrton Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit.

3. Nëse Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit e pranon iniciativën, formon komision të përbërë nga tre profesorë të rregullt, ku dy janë nga drejtimi përkatës mësimor-shkencor ku është zgjedhur kandidati, me detyrë të përgatisë raport në bazë të të cilit do të përgatitet vendim për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes.

4. Vendimi i Komisionit për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes publikohet në buletin e Kolegjit "BIZNESI".

5. Dispozitat e kësaj Rregulloreje për procedurën për zgjedhje në thirrje në mënyrë adekuate zbatohen edhe për procedurën për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes.

Neni 20

Pjesëmarrje të shkencëtarëve të afirmuar, profesionistë nga praktika

1. Me qëllim të prezantimit të të arriturave, shkencëtarë të afirmuar, profesionistë të dalluar nga ekonomia dhe juridiku, mund të marrin pjesë në kryerjen e detyrave të caktuara nga disiplinat mësimore-shkencore, në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Statutin e Kolegjit "BIZNESI".

Neni 21

Procedura e ndryshimit të rregullores

1. Të drejtën e nismës për propozimin e ndryshimeve në këtë rregulloren e kanë:

- a) jo më pak se tre anëtarë të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor;
- b) jo më pak se dy anëtarë të Bordit;
- c) jo më pak se dhjetë anëtarë të personelit akademik të Kolegjit;
- ç) Dekani.

2. Propozimi duhet të shoqërohet me një relacion në të cilin të shpjegohen: qëllimi i ndryshimeve, përparësitë që ato sjellin, kostot financiare, nëse ka dhe çdo e dhënë tjetër që i shërben procesit të ndryshimeve në këtë rregullore.

3. Propozimi i paraqitet Dekanit, i cili ia kalon për konsultim të gjithave njësisive bazë të Kolegjit. Ky proces konsultimi nuk mund të jetë më pak se 30 ditë.

4. Me përfundimin e procedurës së përcaktuar në pikën 3, Dekani propozimin fillestar, relacionin përkatës dhe propozimet e sjella nga njësitë bazë ia përcjell për vendimmarrje Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, i cili vendos sipas kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”.

Neni 22
Dispozita të fundit

1. Kjo rregullore hynë në fuqi me miratimin e saj në Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor.
4. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka dekani i Kolegjit BIZNESI.
5. Miratuar me vendimin Nr. _____ datë __.__.2020, nga Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit BIZNESI.

Prof. Dr. Shyqeri KABASHI

Dekan